

PROFILI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë,
Ekonomive Familjare dhe Banesave

2024



POPULLSIA



EKONOMITË
FAMILJARE



BANESAT



PROFILI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Botues: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Korrik 2026


© Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:

<http://ask.rks-gov.net>

PROFILI I KOMUNĚS
PROFILE OF THE MUNICIPALITY
PROFIL OPŠTINE



Përmbajtja

	Faqe
Parathënie	4
Aspektet administrative	6
Karakteristikat e njësive të banimit.....	9
Karakteristikat e ekonomive familjare	13
Madhësia dhe struktura e popullsisë.....	16
Karakteristikat sociale dhe ekonomike	22
Përmbledhje e treguesve të përzgjedhur	28
Projeksioni i popullsisë për vitet 2025-2040.....	40
Fjalor i termave	49

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka realizuar Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024. Regjistrimi është zhvilluar nga data 5 prill deri më 24 maj 2024, ndërsa momenti kritik i regjistrimit ka qenë data 04-05 prill 2024, ora 24:00, e cila shënon referencën për të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë këtij procesi.

Ky projekt i rëndësishëm ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të realitetit demografik, social dhe ekonomik të vendit tonë.

Në kuadër të publikimeve tematike, ASK-ja ka përgatitur edhe një botim të ri dhe të rëndësishëm: "Profili i komunave të Kosovës".

Ky publikim përmban të dhëna të detajuara në nivel komunal me synim që të mundësoj përdorimin e gjerë të këtyre statistikave nga institucionet vendimarrëse, hulumtuesit, organizatat ndërkombëtare dhe perdoruesit e tjerë të statistikave zyrtare që ndihmojnë në zhvillimin lokal në secilën komunë të Republikës së Kosovës. Objektivi ynë është që këto të dhëna të prezantohen në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe vizualisht tërheqëse për të mundësuar përdorim sa më të gjerë dhe efektiv të tyre.

Profili i komunave paraqet treguesit e shpërndarjes së popullsisë, dendësinë, karakteristikat etnike dhe kulturore, arsimimin, punësimin dhe papunesinë, kushtet e jetesës dhe të banimit si dhe indikatorë të tjerë që ndihmojnë në kuptimin e karakteristikave lokale.

Të gjitha tabelat dhe përmbledhjet statistikore të përfshira në këtë publikim janë krijuar drejtpërdrejt nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit 2024, pas përpunimit të nevojshëm logjik, formal, teknik, tabelar dhe grafik. Përpunimi i të dhënave është kryer me kujdes maksimal për të garantuar saktësinë, përputhshmërinë dhe besueshmërinë e rezultateve.

ASK-ja, thekson rëndësinë e shfrytëzimit të shpjegimeve metodologjike të përfshira në këtë publikim, të cilat janë të domosdoshme për interpretimin e drejtë dhe të saktë të të dhënave. Kuptimi korrekt i këtyre statistikave është thelbësor për formulimin e politikave publike, planifikimin zhvillimor dhe hulumtimin shkencor.

Një nga objektivat kryesore të këtij dokumenti është që autoritetet komunale të kenë më të lehtë të dallojnë ndryshimet në trendet në mesin e popullsisë së komunës së tyre, si dhe t'i ndihmojë ato në planifikimin e zhvillimeve të ardhshme të komunave përkatëse.

Agjencia e Statistikave të Kosovës shpreh mirënjohjen e saj për ndihmën dhe mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në përgatitjen e këtij dokumenti.

Ky Regjistrim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të Sistemit Statistikor të Kosovës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të statistikave zyrtare në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve të vendit.

Ylli Shala	-	Menaxher i Regjistrimit të Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2024
Bekim Canolli	-	Drejtor i Departamentit të Metodologjisë dhe IT
Burim Limolli	-	Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative

Publikimin e përgatiti:

Eduard Jongstra - Konsulent ndërkombëtar, mbështetje nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), fushat e përgjithshme – profili i komunës.

Tomáš Kučera - Konsulent ndërkombëtar, mbështetje nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), për pjesën e projekcionit të popullsisë.

Natalya Kadatskaya - Konsulent ndërkombëtar, mbështetje nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), për pjesën e projekcionit të popullsisë.

Idriz Shala	-	Ekspert për GIS
Burim Gashi	-	Specialist për GIS dhe Hartografi
Valdete Navakazi	-	Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave të Popullsisë
Bujar Hajrizi	-	U.d. Udhëheqës i Divizionit të Statistikave Sociale
Arjeta Sojeva	-	Zyrtare e lartë për statistika vitale
Arbert Abdyli	-	Zyrtar i statistikave të migrimeve
Advie Uka	-	Zyrtare për statistika të arsimit
Drita Sylejmani	-	Zyrtare e lartë e Diseminimit
Arlinda Kosumi	-	Zyrtare për lektorim

Korrik, 2026

Drejtor Ekzekutiv i ASK-së
Avni Kastrati

Aspektet administrative

Komuna e Prizrenit përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 626.9 km². Sipas regjistrimit të vitit 2011, zona urbane e Prizrenit mbulonte 20.1 km², që përbënte 3.2 % të territorit. Ndërmjet regjistrimeve të viteve 2011 dhe 2024, zona urbane e Prizrenit u zgjerua në gjithsej 23.8 km², si rezultat i ndryshimit të statusit të disa vendbanimeve. Si rrjedhojë, pjesa e territorit urban në Prizren arriti në 3.8 %.

Popullsia e komunës së Prizrenit ka shënuar rënie ndërmjet regjistrimeve të viteve 2011 dhe 2024, nga 177,781 banorë në vitin 2011 në 147,246 banorë në vitin 2024. Pjesërisht si pasojë e ndryshimit të statusit nga rural në urban për disa vendbanime, popullsia urbane e Prizrenit ka rënë dukshëm më pak krahasuar me popullsinë rurale. Si rezultat, përqindja e popullsisë që jeton në zona urbane në komunën e Prizrenit është rritur nga 53.2 % në vitin 2011 në 61.3 % në vitin 2024.

Fig. 1: Popullsia urbane dhe rurale 2011 dhe 2024






Fig. 2: Dendësia e popullsisë urbane dhe rurale




Zgjerimi i zonës urbane, i shoqëruar me rënien e numrit të popullsisë, ka rezultuar në uljen e dendësisë së popullsisë urbane në komunën e Prizrenit ndërmjet regjistrimeve të viteve 2011 dhe 2024. Dendësia e popullsisë urbane në Prizren ka rënë nga 4,692 banorë për km² në vitin 2011 në 3,796 në vitin 2024. Gjithashtu, është ulur edhe dendësia e popullsisë në zonat rurale, nga 137 në 95 banorë për km².

Krahasuar me Kosovën në tërësi, dendësia e popullsisë urbane në Prizren mbetet dukshëm më e lartë se mesatarja kombëtare prej 3,190 në vitin 2024. Dendësia e popullsisë rurale gjithashtu ka rënë, por vazhdon të mbetet mbi mesataren kombëtare, e cila ishte 76 banorë për km² në vitin 2024.

Harta. 1: Harta e komunave të Kosovës



Harta. 2: Dendësia e popullsisë sipas komunave– 2024



Karakteristikat e njësive të banimit

Në vitin 2011, komuna e Prizrenit kishte gjithsej 39,640 njësi banimi, prej të cilave 22,202 ose 56.0 % ndodheshin në zonat urbane. Deri në vitin 2024, numri i përgjithshëm i njësive të banimit është rritur në 50,362, prej të cilave 31,453 ose 62.5 % ndodheshin në zonat urbane.

Nga njësitë e banimit të regjistruara në Prizren në regjistrimin e vitit 2011, 77.0 % janë raportuar si “të banuara”. Në zonat urbane të Prizrenit, shkalla e banimit ishte pak më e lartë, 79.3 %. Regjistrimi i vitit 2024 evidentoi një rënie të shkallës së banimit në zonat urbane të komunës së Prizrenit, në 65.5 %. Edhe në zonat rurale të komunës së Prizrenit, shkalla e banimit ka pësuar rënie ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, nga 74.0 % në vitin 2011 në 61.1 % në vitin 2024.

Ndërmjet regjistrimeve të popullsisë të viteve 2011 dhe 2024, numri i banorëve në zonat urbane të komunës së Prizrenit ka shënuar një rënie të lehtë, ndërsa numri i njësive të banimit është rritur. Kjo ka çuar në uljen e raportit ndërmjet popullsisë dhe njësive të banimit, edhe kur merren parasysh vetëm njësitë e banuara. Në vitin 2011, numri mesatar i personave për një njësi banimi të banuar në zonat urbane të komunës së Prizrenit ishte 5.4. Deri në vitin 2024, ky numër ka rënë në 4.4. Në zonat rurale, numri i njësive të banimit të banuara ka rënë, por më pak në krahasim me rënien e numrit të popullsisë. Si rezultat, numri i personave për një njësi banimi të banuar ka rënë nga 6.5 në 4.9.

Fig. 3: Shkalla e shfrytëzimit të njësive të banimit 2011 dhe 2024





Fig. 4: Popullsia për njësi banimi 2011 dhe 2024



Ndërmjet regjistrimeve të viteve 2011 dhe 2024, numri mesatar i dhomave në njësitë e banimit në komunën e Prizrenit është rritur nga 3.6 dhoma për njësi banimi (duke theksuar se kuzhinat, tualetet dhe hapësirat e depozitimit nuk janë numëruar si dhoma), në vitin 2011, në 4.4 në vitin 2024. Sipas regjistrimit të vitit 2024, ekziston një dallim i moderuar në këtë aspekt ndërmjet zonave urbane dhe rurale të Prizrenit, me një mesatare prej 4.3 dhoma për njësi banimi në zonat urbane dhe 4.6 në zonat rurale të komunës.

Fig. 5: Numri i dhomave për njësin banesore 2011 dhe 2024





Fig. 6: Numri i personave për dhomë 2011 dhe 2024



Numri mesatar i personave për dhomë është ulur në Prizren. Në vitin 2011 ky tregues ishte 1.6, ndërsa deri në regjistrimin e vitit 2024 ka rënë në 1.0. Në vitin 2024 pothuajse nuk ka pasur dallime në këtë aspekt ndërmjet zonave urbane dhe rurale të Prizrenit.

Në vitin 2011, 89.7 % e të gjitha njësive të banimit në komunën e Prizrenit kishin qasje në sistemin publik të furnizimit me ujë përmes rrjetit. Deri në vitin 2024, kjo përqindje pothuajse nuk ka ndryshuar. Përqindja e njësive të banimit pa qasje në ujë përmes rrjetit ka rënë nga 0.3 % në vitin 2011 në 0.2 % në vitin 2024.

Fig. 7: Furnizimi me ujë 2011





Fig. 8: Furnizimi me ujë 2024



Sipas regjistrimit të vitit 2024, ekzistojnë disa dallime në furnizimin me ujë ndërmjet zonave urbane dhe rurale të komunës së Prizrenit. Në zonat urbane, 95.8 % e njësive të banimit kishin qasje në sistemin publik të furnizimit me ujë, ndërsa në zonat rurale kjo përqindje ishte 79.2 %. Në zonat rurale, 16.5 % e njësive të banimit furnizohehin me ujë përmes sistemeve private, krahasuar me 3.6 % në zonat urbane.

Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, sistemi i kanalizimit në komunën e Prizrenit është përmirësuar në mënyrë të moderuar. Qasja në sistemin publik të kanalizimit është rritur nga 82.2 % në 94.1 % të të gjitha njësive të banimit. Përqindja e njësive të banimit pa qasje në ndonjë sistem të kanalizimit ka rënë nga 2.6 % në 0.3 %.

Fig. 9: Kanalizimi 2011





Fig. 10: Kanalizimi 2024



Sipas regjistrimit të vitit 2024, në zonat urbane të komunës së Prizrenit 98.8 % e njësive të banimit kishin qasje në sistemin publik të kanalizimit, krahasuar me 85.9 % në zonat rurale. Në zonat rurale të komunës së Prizrenit, 0.4 % e njësive të banimit mbeten pa qasje në kanalizim, ndërsa në zonat urbane kjo përqindje ishte 0.3 %.

Shumica e njësive të banimit në komunën e Prizrenit kanë qasje në tualet me shpëlarje me ujë. Në vitin 2011, 87.4 % e të gjitha njësive të banimit kishin tualet të brendshëm me shpëlarje, ndërsa deri në vitin 2024 kjo përqindje është rritur në 96.7 %. Përqindja e njësive të banimit pa tualet me shpëlarje ka rënë nga 3.7 % në 0.2 % ndërmjet viteve 2011 dhe 2024.

Fig. 11: Tualet me shpëlarje 2011





Fig. 12: Tualet me shpëlarje 2024



Regjistrimi i vitit 2024 evidentoi dallime të vogla ndërmjet njësive të banimit në Prizren sa i përket disponueshmërisë së tualeteve me shpëlarje me ujë. Në zonat urbane, 98.4 % e njësive të banimit kishin qasje në tualet të brendshëm me shpëlarje, krahasuar me 93.8 % në zonat rurale. Përqindja e njësive të banimit pa qasje në tualet me shpëlarje në zonat rurale të Prizrenit ishte 3.9 %, ndërsa në zonat urbane ishte 0.4 %.

Përdorimi i lëndëve djegëse (dru, qymyr ose naftë) si burim kryesor për ngrohjen e njësive të banimit në komunën e Prizrenit ka rënë ndjeshëm ndërmjet regjistrimeve të viteve 2011 dhe 2024. Në kohën e regjistrimit të vitit 2011, 92.5 % e të gjitha njësive të banimit në Prizren përdornin lëndë djegëse për ngrohje. Deri në vitin 2024, kjo përqindje ka rënë në 64.1 %. Ky ndryshim është shkaktuar kryesisht nga rritja e përdorimit të energjisë elektrike si burim ngrohjeje, e cila është rritur nga 7.2 % në vitin 2011 në 29.4 % në vitin 2024.

Fig. 13: Burimi kryesor i ngrohjes 2011





Fig. 14: Burimi kryesor i ngrohjes 2024



Sa i përket burimit të ngrohjes, sipas regjistrimit të vitit 2024, ekzistojnë dallime të mëdha ndërmjet zonave urbane dhe rurale të komunës së Prizrenit. Përdorimi i lëndëve djegëse fosile për ngrohje është dukshëm më i ulët në zonat urbane, me 59.2 %, krahasuar me 85.0 % në zonat rurale. Kjo reflekton kryesisht dallimet në përdorimin e energjisë elektrike si burim ngrohjeje, e cila në zonat urbane arrin në 40.1 %, ndërsa në zonat rurale është 11.4 %.

Karakteristikat e ekonomive familjare

Në vitin 2011, ekonomitë familjare në komunën e Prizrenit përbëheshin mesatarisht nga 6.0 persona. Ekonomitë familjare në pjesën urbane të Prizrenit ishin pak më të vogla, me një mesatare prej 5.4 personash. Madhësia mesatare e ekonomive familjare rurale ishte dukshëm më e madhe, me 6.9 persona. Deri në vitin 2024, madhësia mesatare e ekonomive familjare ka rënë në 4.5 persona. Në zonat urbane, madhësia mesatare e ekonomive familjare në vitin 2024 ishte 4.2 persona, ndërsa në zonat rurale të Prizrenit ekonomitë familjare përbëheshin mesatarisht nga 5.0 persona.

Fig. 15: Madhësia e ekonomive familjare 2011 dhe 2024





Fig. 16: Ekonomitë familjare njëanëtarëshe 2011 dhe 2024



Ekonomitë familjare me një person përfaqësojnë një kategori të veçantë të ekonomive familjare. Zakonisht ato përbëhen nga persona të moshuar beqarë ose të ve, dhe për shkak se jetojnë vetëm, kanë tendencë më të lartë për të pasur nevojë për asistencë sociale. Regjistrimi i vitit 2011 evidentoi gjithsej 925 ekonomi familjare me një person në komunën e Prizrenit, që përbënin 3.1 % të të gjitha ekonomive familjare. Deri në vitin 2024, kjo përqindje është më shumë se dyfishuar, duke arritur në 6.7 %.

Përtej madhësisë së ekonomive familjare, edhe përbërja e tyre është me rëndësi për të kuptuar nevojat aktuale dhe të ardhshme për banim. Prevalenca e ekonomive familjare që përbëhen nga tre ose më shumë gjenerata mund të jetë treguese në këtë aspekt. Megjithatë, ky lloj informacioni nuk është i disponueshëm nga regjistrimi i vitit 2011, prandaj analiza aktuale bazohet ekskluzivisht në të dhënat e regjistrimit të vitit 2024. Lloji më i zakonshëm i ekonomive familjare në komunën e Prizrenit në vitin 2024 ishte ai me dy gjenerata, zakonisht prindër dhe fëmijë, që përbënin 49.9 % të të gjitha ekonomive familjare, ndërsa 18.1 % e tyre përbëheshin nga një gjeneratë e vetme, si dhe pjesa e mbetur, 31.8 %, përbëhej nga tre ose më shumë gjenerata, zakonisht fëmijë, prindër, nipër/mbesa dhe gjyshër. Ekzistojnë disa dallime ndërmjet ekonomive familjare urbane dhe rurale në këtë aspekt. Ekonomitë familjare me një gjeneratë janë më të zakonshme në zonat urbane, duke përbërë 18.5 % në zonat urbane dhe 17.5 % në zonat rurale.

Fig. 17: Numri i gjeneratave në ekonomin familjare 2024 rurale





Fig. 18: Numri i gjeneratave në ekonomitë familjare 2024 urbane



Të pasurit tokë në dispozicion mund të jetë një mekanizëm i rëndësishëm sigurie për familjet, qoftë duke siguruar të ardhura apo duke plotësuar furnizimin ushqimor për vetëkonsum. Në vitin 2011, 47.1 % e të gjitha familjeve në komunën e Prizrenit kishin tokë në dispozicion. Deri në vitin 2024, kjo përqindje ka rënë në 41.4 %.

Rezultatet nga regjistrimi i vitit 2024 tregojnë se 28.2 % e familjeve në zonat urbane të komunës së Prizrenit kishin tokë ne dispozicion, krahasuar me 65.9 % të familjeve në zonat rurale.

Fig. 19: Ekonomitë familjare me tokë në dispozicion 2011 dhe 2024






Fig. 20: Ekonomitë familjare me tokë në dispozicion, urbane, rurale, 2024



Regjistrimet e popullsisë dhe banesave në Kosovë kanë përfshirë gjithashtu pyetje lidhur me faktin nëse familjet posedojnë ndonjë lloj bagëtie. Megjithatë, këto të dhëna janë të disponueshme vetëm nga regjistrimi i vitit 2024. Nga të gjitha familjet në komunën e Prizrenit, 6.9 % kanë raportuar se kanë bagëti. Në zonat urbane kjo përqindje ishte dukshëm më e ulët, siç pritet, vetëm 1.7 %. Ndërsa për familjet në zonat rurale, përqindja e atyre që raportuan se posedojnë bagëti ishte 16.7 %.

Fig. 21: Ekonomitë familjare që posedojnë bagëti 2024



Madhësia dhe struktura e popullsisë

Siç është theksuar tashmë, të dhënat nga regjistrimet e popullsisë të viteve 2011 dhe 2024 tregojnë një rënie të numrit të popullsisë në komunën e Prizrenit. Numri i përgjithshëm i popullsisë ka rënë nga 177,781 në vitin 2011 në 147,246 në vitin 2024. Kjo përfaqëson një rënie prej 17.2 % gjatë periudhës 13-vjeçare ndërmjet dy regjistrimeve, ose mesatarisht 1.4 në vit.

Dallimet ndërmjet meshkujve dhe femrave në këtë aspekt ishin shumë të vogla. Popullsia mashkullore e komunës së Prizrenit ka rënë pak më shumë se ajo femërore, me 17.8 % ose 1.5 % në vit, krahasuar me 16.5 % ose 1.4 % në vit për femrat. Ky ndryshim reflektohet edhe në raportin gjinor (numri i meshkujve për 100 femra), i cili ka rënë nga 100.6 në 99.1 gjatë periudhës ndërmjet dy regjistrimeve.

Rënia e numrit të popullsisë ishte më e theksuar te popullsia e re në Prizren. Numri i fëmijëve (0–14 vjeç) ka rënë me 35.3 %, ose mesatarisht 3.4 % në vit. Një rënie e ngjashme është vërejtur edhe te të rinjtë (15–24 vjeç), numri i të cilëve ka rënë me 33.9 % ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, ose 3.2 % në vit. Në këto grupmosha, meshkujt ishin disi më të shumtë se femrat, një prirje që vazhdoi edhe gjatë periudhës ndërmjet regjistrimeve, për shkak të ritmeve pak më të ulëta të rënies te meshkujt e këtyre moshave.

Numri i personave në moshë pune (25–64 vjeç) në komunën e Prizrenit gjithashtu ka rënë ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, por me një ritëm shumë më të ulët, prej 7.8 % ose 0.6 % në vit. Nuk ka pasur dallime të mëdha në rënie ndërmjet meshkujve dhe femrave. Si rrjedhojë, raporti gjinor për këtë grupmoshë ka mbetur pothuajse i pandryshuar, duke kaluar nga 96.5 në vitin 2011 në 95.1 në vitin 2024.

Madhësia e grupmoshës së personave të moshuar (65–79 vjeç) në komunën e Prizrenit u rrit midis viteve 2011 dhe 2024 me 41.6 %, ose mesatarisht 2.7 % në vit. Numri i meshkujve në këtë grupmoshë u rrit disi më shumë se ai i femrave. Rritja e numrit të meshkujve arriti në 43.3 % (2.8 % në vit), krahasuar me 40.2 % për femrat gjatë intervalit 13-vjeçar (2.6 % në vit). Dallimet midis meshkujve dhe femrave në madhësinë e popullsisë pasqyrohen edhe në raportin gjinor për këtë grupmoshë, i cili u rrit nga 87.2 në 89.1. Megjithatë, pavarësisht ritmit më të lartë të rritjes te meshkujt e moshës 65–79 vjeç, raporti gjinor mbeti dukshëm nën 100, çka tregon se ka më shumë femra se meshkuj. Ky është një model i zakonshëm, i shkaktuar kryesisht nga vdekshmëria më e lartë te meshkujt.

Ndër më të moshuarit (80 vjeç e më shumë) vërehet një model i ngjashëm me atë të grupmoshës 65–79 vjeç, por në një shkallë më të theksuar. Popullsia në këtë grupmoshë u rrit me 53.3 % midis viteve 2011 dhe 2024, që korrespondon me një normë mesatare vjetore prej 3.3 %. Numri i meshkujve në këtë grupmoshë u rrit dukshëm më shumë se ai i femrave gjatë periudhës ndërmjet dy regjistrimeve, me rritje përkatësisht prej 59.7 % dhe 48.8 %. Këto vlera përkthehen në norma vjetore rritjeje prej 3.6 % për meshkuj dhe 3.1 % për femra. Raporti gjinor në këtë grupmoshë pasqyron këtë rritje më të shpejtë të meshkujve, duke u rritur nga 70.4 në 75.6.

Fig. 22: Shkalla vjetore e rritjes se popullsisë 2011-2024





Fig. 23: Raporti gjinor 2011 dhe 2024



Struktura moshore e popullsisë në komunën e Prizrenit për vitin 2011 tregon rënie të numrit të fëmijëve, një trend që kishte filluar rreth 15 vjet më herët. Shpjegimi kryesor për këtë rënie është ulja e niveleve të fertilitetit. Analiza e strukturës moshore për vitin 2024 tregon vazhdimësinë e këtij trendi.

Struktura moshore e vitit 2024 zbulon gjithashtu parregullsi në popullsinë në moshë pune (25–64 vjeç). Si te meshkujt ashtu edhe te femrat vërehet një mungesë relative në grupmoshat 25–45 vjeç. Kjo mungesë është më e theksuar te femrat sesa te meshkujt. Shpjegimi më i mundshëm për këtë fenomen është migrimi.

Fig. 24: Struktura sipas moshës 2011





Fig. 25: Struktura sipas moshës 2024



Një tjetër vëzhgim që mund të bëhet nga struktura moshore e popullsisë së komunës së Prizrenit në vitin 2024 lidhet me plakjen e popullsisë. Jo vetëm që përqindja e personave të moshuar (65–79 vjeç) dhe e më të moshuarve (80+ vjeç) është dukshëm më e lartë krahasuar me vitin 2011, por struktura moshore tregon gjithashtu se në këto grupmosha femrat janë dukshëm më të shumta se meshkujt.

Ndërsa përqindja e personave të moshuar dhe shumë të moshuar është rritur gjatë periudhës ndërmjet dy regjistrimeve, përqindja e fëmijëve dhe e të rinjve është ulur. Në balancën e përgjithshme, përqindja e personave në moshë pune (25–64 vjeç) është rritur. Megjithatë, ky është një fenomen i përkohshëm. Rënia

e numrit të fëmijëve pritet të ngadalësohet, ndërsa rritja e numrit të personave të moshuar pritet të përshpejtohet, duke çuar në uljen e numrit dhe përqindjes së popullsisë në moshë pune në të ardhmen.

Fig. 26: Përbërja e popullsisë sipas moshës 2011





Fig. 27: Përbërja e popullsisë sipas moshës 2024



Dinamika e popullsisë në komunën e Prizrenit tregon dallime të vogla në normat e rritjes së popullsisë në mes zonave urbane dhe rurale. Të dyja zonat kanë përjetuar rënie të popullsisë, por kjo ka qenë dukshëm më e theksuar në zonat rurale. Rënia e përmendur më herët në përqindjen e të rinjve ka ndodhur kryesisht në popullsinë rurale. Rritja e përqindjes së personave të moshuar është vërejtur si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale të Prizrenit, por ka qenë më e theksuar në zonat urbane. Megjithatë, raportet gjinore kanë qenë mjaft të ngjashme midis popullsisë urbane dhe rurale, duke u ulur me rritjen e moshës.

Fig. 28: Normat vjetore të rritjes së popullsisë urbane 2011-2024




Fig. 29: Normat vjetore të rritjes së popullsisë rurale 2011-2024




Fig. 30: Raporti gjinor 2011 dhe 2024 urban





Fig. 31: Raporti gjinor 2011 dhe 2024 rural



Strukturat moshore të popullsisë urbane dhe rurale të Prizrenit në vitet 2011 dhe 2024 duken mjaft të ngjashme, por kanë pësuar ndryshime të mëdha ndërmjet dy regjistrimeve. Strukturat moshore në vitin 2011, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, tregonin një trend drejt uljes së numrit të fëmijëve, por përndryshe ishin mjaft të rregullta.

Deri në vitin 2024, ndikimet e migrimit dhe lëvizshmërisë kanë prekur ndjeshëm popullsinë në moshë pune, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale të Prizrenit. Po ashtu, vihet re se strukturat moshore në vitin 2024 sugjerojnë se rënia e fertilitetit, e cila ishte e dukshme në të dhënat e vitit 2011, mund të jetë ngadalësuar.

Fig. 32: Strukturat moshore urbane 2011




Fig. 33: Strukturat moshore urbane 2024




Fig. 34: Strukturat moshore rurale 2011





Fig. 35: Strukturat moshore rurale 2024



Struktura moshore e analizuar mbi bazën e grupmoshave të gjera tregon dallime të konsiderueshme midis popullsisë së Prizrenit në vitet 2011 dhe 2024. Sa i përket dallimeve urbane/rurale, vërehet se përqindja e popullsisë në moshë pune në zonat rurale është rritur më shumë sesa në zonat urbane. Megjithatë, duhet theksuar se si popullsia urbane ashtu edhe ajo rurale e Prizrenit kanë përjetuar një zvogëlim të vazhdueshëm të brezave të fëmijëve, çka nënkupton se rritja relative e peshës së popullsisë në moshë pune ka gjasa të jetë një fenomen i përkohshëm.

Fig. 36: Përberja e popullsisë sipas moshës 2011 urbane




Fig. 37: Përberja e popullsisë sipas moshes 2024 urbane




Fig. 38: Përberja e popullsisë sipas moshës
2011 rurale





Fig. 39: Përberja e popullsisë sipas moshës
2024 rurale



Karakteristikat sociale dhe ekonomike

Sipas regjistrimeve të popullsisë të viteve 2011 dhe 2024, përbërja etnike e popullsisë në komunën e Prizrenit ka ndryshuar shumë pak gjatë periudhës ndërmjet dy regjistrimeve. Shumica e popullsisë është deklaruar me përkatësi etnike shqiptare. Grupi më i madh i pakicave etnike përbëhej nga ata që janë deklaruar si boshnjakë, i ndjekur nga turqit. Të gjitha grupet e tjera të pakicave etnike ishin gjithashtu të pranishme në numër më të vogël.

Fig. 40: Përkatësia etnike 2011





Fig. 41: Përkatësia etnike 2024



Gjuha dhe përkatësia etnike zakonisht përputhen ngushtë. Kjo vërtetohet edhe nga të dhënat e regjistrimeve të popullsisë në Kosovë. Shumica dërmuese e banorëve të komunës së Prizrenit kanë deklaruar gjuhën shqipe si gjuhë amtare. Ndër gjuhët e tjera të përdorura, më e përhapura ishte boshnjakishtja, e ndjekur nga turqishtja. Edhe pse në numër shumë të vogël, vlen të theksohet se në komunën e Prizrenit janë raportuar gjithashtu edhe gjuha rome dhe serbishtja.

Fig. 42: Gjuhet 2011





Fig. 43: Gjuhet 2024



Në regjistrimin e vitit 2011, ashtu edhe në atë të vitit 2024, shumica dërmuese e popullsisë në komunën e Prizrenit e ka deklaruar besimin e tyre fetar si "islam". Popullsia përfshinte gjithashtu një përqindje të konsiderueshme, ndonëse në rënie, të katolikëve. Besimi fetar ortodoks është raportuar nga një numër i vogël i të anketuarve. Përqindja e personave që kanë deklaruar besimin e tyre fetar si "tjetër" ose "asnjë" është rritur ndjeshëm ndërmjet viteve 2011 dhe 2024.

Fig. 44: Përkatësia fetare 2011





Fig. 45: Përkatësia fetare 2024



Arsimi konsiderohet gjerësisht si faktori më i rëndësishëm që përcakton mundësitë e individëve në tregun e punës dhe, në mënyrë më të gjerë, mirëqenien e tyre të përgjithshme. Si tregues përmbljedhës i nivelit të arsimimit, kjo analizë përdor përqindjen e popullsisë së moshës 25–64 vjeç që kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm të lartë ose një nivel më të lartë arsimor. Nivelet e arsimit të raportuara sipas sistemeve të vjetra dhe të reja të klasifikimit janë harmonizuar për të mundësuar krahasimin e tyre. Sipas të dhënave të regjistrimeve përkatëse të popullsisë, ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, shkalla e përgjithshme e arritjes arsimore në komunën e Prizrenit është rritur nga 37.1 % në 49.1 %. Megjithatë, vlera e regjistruar në vitin 2024 mbetet dukshëm më e ulët se mesatarja kombëtare prej 62.5 %. Edhe nivelet e arritjes arsimore për meshkujt dhe femrat në vitin 2024 ishin nën mesataren kombëtare. Për meshkujt, kjo shkallë ishte 58.8 %, krahasuar me mesataren kombëtare prej 74.3 %. Për femrat, shkalla e arritjes arsimore ishte 39.8 %, ndërsa mesatarja kombëtare arrinte në 51.0 %.

Ndër popullsinë urbane dhe rurale të komunës së Prizrenit, nivelet e arritjes së arsimit të mesëm të lartë ose të lartë si për meshkujt ashtu edhe për femrat janë rritur ndërmjet viteve 2011 dhe 2024. Megjithatë, ato mbeten dukshëm më të ulëta se mesataret kombëtare, të cilat janë 80.7 % për meshkuj urban dhe 64.4 % për femra urbane, si dhe 67.8 % për meshkuj rural dhe 36.7 % për femra rurale. Veçanërisht, nivelet e arritjes arsimore në popullsinë rurale, si për meshkujt ashtu edhe për femrat, janë ndër më të ulëtat në të gjithë Kosovën.

Fig. 46: Popullsia e moshës 25-64 vjeç me arsim të mesëm të lartë ose arsim të lartë, 2011





Fig. 47: Popullsia e moshës 25-64 vjeç me arsim të mesëm të lartë ose arsim të lartë, 2024



Popullsia në moshë pune zakonisht përkufizohet si grupi i moshës 15 deri 64 vjeç. Megjithatë, për të qenë konkurrues në tregun e sotëm të punës, arsimi i lartë ose trajnimi profesional po bëhen gjithnjë e më të rëndësishëm. Përveç kësaj, shpesh nevojitet kohë pas përfundimit të shkollimit derisa një i ri të gjejë punë. Për këto arsye, analiza e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe e punësimit e ndan grupmoshën 15–64 vjeç në dy pjesë: 15–24 dhe 25–64 vjeç.

Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë në komunën e Prizrenit u rrit nga 30.0 % në 33.1 %, sipas të dhënave përkatëse të regjistrimeve të popullsisë. Vlera e vitit 2024 ishte pak më e ulët se mesatarja kombëtare, e cila ishte 35.7 %. Vlen të theksohet se mesatarja e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës në vendet evropiane zakonisht sillet në intervalin 40–45 %.

Dallimi në shkallën e pjesëmarrjes në tregun e punës ndërmjet femrave dhe meshkujve të rinj ishte relativisht i madh krahasuar me shumicën e komunave të tjera në Kosovë, duke qenë 24.4 % për femrat e reja dhe 41.2 % për meshkujt e rinj.

Papunësia e të rinjve në të gjithë Kosovën ishte jashtëzakonisht e lartë në vitin 2011. Bazuar në regjistrimin e popullsisë së vitit 2011, u llogarit një mesatare kombëtare e papunësisë së të rinjve prej 64.6 %. Në komunën e Prizrenit, kjo vlerë në vitin 2011 ishte 60.6 %. Deri në vitin 2024, kjo normë kishte rënë ndjeshëm në 18.9 %, me 16.1 % për të rinjtë meshkuj dhe 23.8 % për të rinjtë femra. Mesatarja kombëtare në vitin 2024, bazuar në të dhënat e regjistrimit, ishte 19.3 %, e përbërë nga 17.8 % për meshkujt e rinj dhe 21.3 % për femrat e reja.

Fig. 48: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas moshës 15-24, viti 2011-2024





Fig. 49: Shkalla e papunësisë, moshë 15-24, viti 2011-2024



Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për popullsinë e komunës së Prizrenit të moshës 25–64 vjeç ka shënuar një rënie të lehtë, nga 50.6% në 48.7%, sipas regjistrimeve përkatëse të popullsisë. Vlera e fundit ishte më e ulët se mesatarja kombëtare, e cila në vitin 2024 ishte 52.5%, e llogaritur në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024. Kjo shkallë ishte dukshëm më e ulët krahasuar me shumicën e vendeve evropiane, ku zakonisht tejkalon 70 %. Dallimi në shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ndërmjet meshkujve dhe femrave ishte shumë i madh, me 69.7 % për meshkujt dhe 28.7 % për femrat.

Ngjashëm me papunësinë e të rinjve, shkallët e papunësisë për popullsinë e moshës 25–64 vjeç ishin jashtëzakonisht të larta në gjithë Kosovën në vitin 2011, me një mesatare kombëtare prej 40.5 %, sipas regjistrimit të popullsisë dhe banesave të atij viti. Në komunën e Prizrenit, shkalla e papunësisë për këtë grupmoshë në vitin 2011 ishte 39.2 %. Deri në vitin 2024, kjo shkallë kishte rënë në 11.3 %, duke qenë pak më e ulët se mesatarja kombëtare prej 12.7 %, e llogaritur në bazë të të dhënave të regjistrimit të popullsisë.

të vitit 2024. Vlen të theksohet se mesatarja e papunësisë në Bashkimin Evropian ishte rreth 6 % në vitin 2024. Shkalla e papunësisë për femra në komunën e Prizrenit, prej 18.4 %, ishte pothuajse dy herë më e lartë se ajo për meshkuj.

Fig. 50: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas moshës 25-64, 2011-2024






Fig. 51: Shkalla e papunësisë, moshë 25-64 2011-2024



Përveç pjesëmarrjes në forcat e punës të popullsisë në moshë pune, regjistrimi i popullsisë në Kosovë ka përfshirë gjithashtu edhe aktivitetin ekonomik të personave mbi moshën 65 vjeç. Edhe pse këto norma janë zakonisht shumë të ulëta, ato japin një tregues të nevojës ekonomike ose mundësive për të moshuarit.

Në komunën e Prizrenit, shkalla e aktivitetit ekonomik të personave të moshuar (65–84 vjeç) në vitin 2024 ishte 2.1 %, e njëjtë me mesataren kombëtare të këtij treguesi, e cila po ashtu ishte 2.1 %, e llogaritur në bazë të regjistrimit të popullsisë së vitit 2024. Shkalla e aktivitetit ekonomik të të moshuarve ishte më e lartë në pjesën urbane të komunës së Prizrenit krahasuar me pjesën rurale, dhe veçanërisht më e lartë tek meshkujt e moshuar në këtë pjesë të komunës, me 4.4 % për meshkuj e moshuar dhe 0.9 % për femrat e moshuara.

Fig. 52: Ekonomikisht aktive, moshë 65-84



Lëvizshmëria e njerëzve zakonisht lidhet me qasjen e tyre në punë dhe arsim. Të dhënat mbi frekuencën e udhëtimeve të përditshme për në punë ose shkollë ofrojnë një pasqyrë mbi këtë qasje dhe mund të tregojnë edhe nevojën për transport publik. Përqindja e popullsisë në komunën e Prizrenit që udhëton çdo ditë u rrit ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, nga 13.4 % në 23.5 %. Këto vlera ishin të afërta me mesataret kombëtare, të cilat ishin 14.2 % në vitin 2011 dhe 24.1 % në vitin 2024. Përqindjet e personave që udhëtojnë më rrallë ishin të ulëta dhe pësuan rënie ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, duke mbetur gjithsesi në nivele të ulëta. Kjo e bën Prizrenin një nga pak komunat në Kosovë ku është vërejtur një rënie e udhëtimeve të rralla.

Fig. 53: Shpeshtësia e udhetimit, 2011





Fig. 54: Shpeshtësia e udhetimit, 2024



Edhe pse regjistrimi i popullsisë zakonisht nuk është i përshtatshëm për mbledhjen e të dhënave mbi të ardhurat e individëve, informacioni mbi burimin kryesor të të ardhurave mund të ofrojë të dhëna të rëndësishme. Me interes të veçantë në këtë drejtim është përqindja e personave që mbështeten në pensione, përfitime të tjera sociale ose remitanca si burimi kryesor i të ardhurave. Duhet theksuar se të dhënat e paraqitura këtu i referohen të gjithë popullsisë, dhe mund të supozohet se burimi i të ardhurave për të gjithë fëmijët kategorizohet si “persona të tjerë”.

Shpërndarja e burimeve të të ardhurave në komunën e Prizrenit pasqyron disa nga trendet kryesore të vërejtura në pjesët e mëparshme të kësaj analize. Ndryshimi më i dukshëm ndërmjet viteve 2011 dhe 2024 është rritja e përqindjes së popullsisë që mbështetet në pensione, nga 5.4 % në 10.2 %. Po ashtu, është rritur edhe përqindja e popullsisë që mbështetet kryesisht në të ardhurat nga puna, nga 22.7 % në 25.9 %.

Edhe pse përqindja e popullsisë që mbështetet në remitanca si burim kryesor të të ardhurave ka shënuar një rënie të lehtë ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, ajo mbetet ndër më të lartat në Kosovë në vitin 2024. Përqindja e personave që mbështeten në “persona të tjerë” për jetesën e tyre gjithashtu ka rënë lehtë deri në vitin 2024. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka raportuar burime “të tjera” të të ardhurave.

Fig. 55: Burimi kryesor i të ardhurave 2011





Fig. 56: Burimi kryesor i të ardhurave 2024



Tek popullsia urbane e Prizrenit, përqindja e atyre që deklaruan “punën” si burimin kryesor të të ardhurave është rritur ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, ndërsa te popullsia rurale e komunës kjo përqindje ishte relativisht e ulët në vitin 2011 dhe ka shënuar një rënie të lehtë deri në vitin 2024. Është vërejtur një rritje e dukshme e varësisë nga pensionet si burim kryesor i të ardhurave ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, në një masë të ngjashme si te popullsia urbane ashtu edhe ajo rurale e Prizrenit. Varësia nga remitencat ishte e ulët te popullsia urbane e Prizrenit dhe ka pësuar një rënie të lehtë ndërmjet viteve 2011 dhe 2024. Nga ana tjetër, pjesa e popullsisë rurale që mbështetet në remitenca ishte ndër më të lartat në Kosovë dhe ka shënuar një rritje të lehtë gjatë kësaj periudhe. Si te popullsia urbane ashtu edhe ajo rurale, përqindja e atyre që kanë deklaruar “persona të tjerë” si burimin kryesor të të ardhurave ka shënuar një rënie të lehtë deri në vitin 2024.

Fig. 57: Burimi kryesor i të ardhurave 2011, urbane




Fig. 58: Burimi kryesor i të ardhurave 2024, urbane




Fig. 59: Burimi kryesor i të ardhurave 2011, rurale





Fig. 60: Burimi kryesor i të ardhurave 2024, rurale



Përmbledhje e treguesve të përzgjedhur

Kjo pjesë përfundimtare e profileve komunale paraqet një përmbledhje të vlerave për disa tregues që janë përzgjedhur, të nxjerra nga regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë i vitit 2024. Treguesit që lidhen me ndryshimet e popullsisë bazohen në rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe banesave të vitit 2011.

Këta tregues mbulojnë të gjitha komunat në Kosovë, me qëllim që të mundësohet krahasimi ndërmjet komunave. Këtu paraqiten vetëm vlerat totale, pa ndarje sipas zonave urbane/rurale apo sipas gjinisë (meshkuj/femra). Mesataret kombëtare paraqesin mesatare të peshuara për të gjitha komunat. Duhet theksuar se tregues të ngjashëm të nxjerrë nga burime të tjera të të dhënave mund të kenë vlera të ndryshme.

Tab. 1: Popullsia dhe urbanizimi në komunat e Kosovës (2024)

Komunat	Popullsia 2024	Ndryshimet e popullsisë 2011-2024	Sipërfaqja km ²	Dendësia	Popullsia urbane në %	Sipërfaqja urbane
Deçan	27,775	-30.6%	294	94	19.4%	1.1%
Gjakovë	78,699	-16.8%	587	134	56.4%	2.0%
Gillogovc	48,079	-17.9%	276	174	25.6%	2.6%
Gjilan	82,980	-8.0%	392	212	64.2%	3.6%
Dragash	28,896	-15.0%	434	67	4.6%	0.2%
Istog	33,008	-16.0%	454	73	25.6%	1.5%
Kaçanik	27,716	-17.0%	211	131	34.8%	1.4%
Klinë	30,503	-20.8%	309	99	27.0%	1.4%
Fushë Kosovë	63,949	83.6%	84	760	79.6%	8.8%
Kamenicë	22,868	-51.5%	417	55	39.1%	1.2%
Mitrovicë	64,742	-10.0%	331	196	72.0%	3.8%
Leposaviq	9,485	-31.1%	539	18	27.1%	0.2%
Lipjan	55,044	-4.4%	338	163	23.8%	1.3%
Novobërdë	4,493	-33.2%	204	22	5.7%	0.2%
Obiliq	22,815	5.9%	105	218	33.5%	3.7%
Rahovec	41,799	-25.6%	276	152	32.6%	2.0%
Pejë	82,745	-14.2%	603	137	51.4%	2.8%
Podujevë	70,975	-19.8%	633	112	28.6%	1.2%
Prishtinë	227,466	14.4%	523	435	90.1%	8.8%
Prizren	147,246	-17.2%	627	235	61.3%	3.8%
Skenderaj	40,664	-20.0%	374	109	27.5%	0.9%
Shtime	24,308	-11.0%	134	181	30.8%	3.3%
Shtërpçë	10,771	46.7%	248	43	22.6%	0.6%
Suharekë	45,749	-5.0%	361	127	21.6%	1.7%
Ferizaj	109,255	0.6%	345	317	51.2%	4.1%
Viti	35,566	-24.3%	270	132	16.3%	1.4%
Vushtrri	61,528	-24.3%	345	178	47.6%	2.4%
Zubin Potok	3,385	-48.8%	334	10	21.0%	0.3%
Zveqan	2,867	-56.7%	123	23	51.2%	0.8%
Malishevë	43,888	-19.6%	306	143	8.8%	0.8%
Junik	3,943	-35.2%	78	51	99.5%	4.2%
Mamushë	5,607	1.8%	11	513	100.0%	12.4%
Hani i Elezit	8,533	-9.3%	83	103	29.9%	1.1%
Graçanicë	18,486	73.2%	122	151	54.0%	4.4%
Ranillug	2,481	-35.8%	78	32	25.5%	0.6%
Partesh	3,240	81.3%	29	113	37.8%	2.4%
Kllokot	3,041	19.0%	23	130	48.0%	4.7%
Mitrovicë Veriore	7,920	19.7%	5	1451	97.0%	34.0%
Kosovë	1,602,515	-10.0%	10,905	147	50.2%	2.3%

Tab. 2: Kushtet e banimit sipas komunave (2024)

Komunat	Njësithë banesore të banuara	Numri i dhomave për njësi banesore	Numri i personave për dhomë	Sistemi publik i furnizimit me ujë	Sistemi publik i kanalizimit	Tualet me shpërlarje Brenda njësisë së banesës	Ngrohja me lëndë djegëse
Deçan	66.9%	4.9	0.9	81.9%	39.0%	98.6%	83.6%
Gjakovë	64.6%	4.4	1.0	95.4%	70.9%	97.9%	59.0%
Gillogoc	74.9%	4.3	1.1	42.7%	88.9%	98.6%	74.2%
Gjilan	59.5%	4.1	1.0	66.4%	82.9%	98.1%	63.9%
Dragash	53.7%	4.7	0.8	56.1%	54.2%	96.2%	93.3%
Istog	57.1%	4.3	1.0	91.7%	67.4%	95.2%	82.0%
Kaçanik	69.0%	4.2	1.1	74.6%	83.5%	99.4%	83.9%
Klinë	58.7%	4.7	1.0	46.0%	80.9%	98.0%	75.5%
Fushë Kosovë	60.1%	3.3	1.2	83.8%	95.2%	96.3%	26.4%
Kamenicë	61.9%	4.0	0.9	39.0%	78.5%	89.8%	83.9%
Mitrovicë	62.8%	3.9	1.1	96.4%	86.6%	99.3%	61.0%
Leposaviq	55.1%	2.7	1.0	50.1%	38.2%	80.9%	94.3%
Lipjan	62.3%	4.0	1.1	41.2%	94.3%	98.6%	69.4%
Novobërdë	61.9%	4.3	1.0	26.9%	66.7%	91.1%	82.4%
Obiliq	78.8%	3.6	1.3	86.9%	93.4%	97.2%	75.3%
Rahovec	70.2%	4.5	1.0	95.0%	93.2%	97.0%	70.7%
Pejë	71.8%	4.2	1.0	88.1%	66.7%	97.8%	61.8%
Podujevë	69.7%	3.6	1.3	59.4%	89.6%	95.1%	82.4%
Prishtinë	66.2%	3.6	1.0	97.3%	97.3%	99.4%	40.4%
Prizren	63.8%	4.4	1.0	89.8%	94.1%	96.7%	64.1%
Skenderaj	66.4%	4.1	1.2	61.4%	80.1%	95.6%	76.7%
Shtime	70.1%	4.5	1.1	49.9%	83.9%	99.5%	79.4%
Shtërpçë	66.3%	3.4	1.0	72.2%	76.0%	93.3%	93.3%
Suharekë	57.7%	4.8	0.8	57.5%	80.2%	95.1%	74.6%
Ferizaj	60.0%	4.1	1.1	74.8%	94.8%	98.9%	57.6%
Viti	58.6%	4.4	1.0	32.0%	92.4%	99.2%	80.7%
Vushtrri	64.0%	3.7	1.2	84.8%	84.7%	98.8%	66.3%
Zubin Potok	40.4%	3.8	1.0	81.5%	79.3%	99.5%	57.9%
Zveqan	18.9%	2.5	1.7	84.6%	52.9%	100.0%	84.6%
Malishevë	63.3%	4.6	1.1	36.2%	92.9%	96.6%	77.2%
Junik	67.2%	5.6	0.8	99.7%	94.9%	99.9%	73.7%
Mamushë	90.7%	5.8	1.0	20.2%	92.5%	98.6%	72.0%
Hani i Elezit	82.0%	4.2	1.1	62.8%	90.4%	99.4%	87.6%
Graçanicë	76.3%	3.6	1.1	83.0%	90.5%	98.4%	56.3%
Ranillug	72.0%	3.1	1.2	39.4%	75.2%	92.0%	94.9%
Partesh	73.7%	3.8	0.9	32.6%	86.3%	93.5%	90.1%
Kllokot	73.7%	4.0	1.1	29.7%	84.5%	93.5%	83.7%
Mitrovicë Veriore	58.0%	3.4	0.9	99.9%	99.4%	100.0%	57.0%
Kosovë	64.3%	4.1	1.0	76.3%	86.1%	97.6%	64.5%

Tab. 3: Karakteristikat e ekonomive familjare sipas komunave (2024)

Komunat	Madhësia e Ekonomisë familjare	Ekonomia familjare me një person	3+ gjenerata në ekonomi familjare	% Ekonomitë familjare me tokë në dispozicion	% Ekonomitë familjare me blektori në dispozicion
Deçan	4.7	6.8%	32.9%	85.9%	29.1%
Gjakovë	4.2	7.8%	26.2%	38.1%	16.5%
Gllgovc	4.9	3.2%	32.4%	88.9%	32.8%
Gjilan	4.2	6.0%	25.3%	31.7%	9.1%
Dragash	4.1	7.6%	26.1%	34.1%	7.8%
Istog	4.3	8.0%	24.8%	78.8%	28.8%
Kaçanik	4.7	3.6%	30.8%	54.5%	20.3%
Klinë	4.5	5.6%	28.8%	74.8%	32.4%
Fushë Kosovë	4.0	7.9%	17.8%	33.7%	7.2%
Kamenicë	3.8	8.9%	23.1%	73.5%	22.6%
Mitrovicë	4.2	7.6%	22.8%	33.9%	8.2%
Leposaviq	2.7	28.4%	8.5%	49.5%	24.0%
Lipjan	4.5	4.7%	26.0%	66.9%	28.7%
Novobërdë	4.3	8.1%	25.0%	88.3%	24.3%
Obiliq	4.6	5.1%	25.8%	65.1%	21.7%
Rahovec	4.6	5.3%	32.1%	67.8%	14.1%
Pejë	4.2	9.7%	25.3%	53.1%	13.8%
Podujevë	4.8	4.1%	30.6%	82.7%	26.4%
Prishtinë	3.9	9.8%	18.0%	32.4%	3.0%
Prizren	4.5	6.7%	31.8%	41.4%	6.9%
Skenderaj	4.8	4.9%	31.8%	69.5%	35.7%
Shtime	5.0	3.0%	34.8%	69.6%	26.9%
Shtërpcë	3.6	15.5%	19.0%	31.4%	7.7%
Suharekë	4.1	6.1%	23.0%	66.2%	16.1%
Ferizaj	4.5	5.4%	27.4%	43.2%	13.3%
Viti	4.5	4.8%	29.5%	57.1%	27.6%
Vushtrri	4.4	5.1%	25.6%	55.9%	19.1%
Zubin Potok	4.0	9.4%	22.5%	80.1%	31.4%
Zveqan	4.1	11.4%	21.0%	73.3%	36.2%
Malishevë	5.1	3.0%	34.5%	88.4%	24.9%
Junik	4.4	8.4%	28.0%	76.5%	21.9%
Mamushë	6.4	2.1%	45.6%	45.0%	7.7%
Hani i Elezit	4.9	3.1%	32.4%	26.1%	8.1%
Graçanicë	4.5	8.4%	21.7%	49.0%	15.3%
Ranillug	3.8	12.4%	27.0%	73.7%	38.1%
Partesh	3.5	12.5%	21.2%	63.8%	35.9%
Klllokot	4.6	6.9%	33.3%	51.4%	42.9%
Mitrovicë Veriore	3.2	23.0%	9.7%	8.2%	1.0%
Kosovë	4.3	7.0%	25.8%	50.9%	15.1%

Tab. 4: Ndryshimet demografike sipas grupmoshave dhe sipas komunave (2011-2024)

Komunat	Ndryshimi i popullsisë 0-14	Ndryshimi i popullsisë 15-24	Ndryshimi i popullsisë 25-64	Ndryshimi i popullsisë 65-79	Ndryshimi i popullsisë 80+	% Udhëtimi i përditshëm (vajtje-ardhje)
Deçan	-46%	-47%	-23%	20%	43%	14.6%
Gjakovë	-38%	-35%	-6%	41%	55%	24.0%
Glllogoc	-32%	-34%	-8%	37%	45%	22.5%
Gjilan	-30%	-27%	5%	36%	79%	25.2%
Dragash	-38%	-30%	-6%	33%	33%	11.0%
Istog	-39%	-29%	-6%	37%	55%	21.3%
Kaçanik	-33%	-28%	-9%	38%	42%	20.6%
Klinë	-40%	-36%	-9%	36%	55%	17.0%
Fushë Kosovë	65%	52%	101%	128%	139%	32.0%
Kamenicë	-58%	-52%	-29%	16%	30%	20.4%
Mitrovicë	-28%	-15%	-5%	43%	64%	22.1%
Leposaviq	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	7.4%
Lipjan	-23%	-13%	5%	49%	57%	24.7%
Novobërdë	-35%	-40%	-29%	-36%	-33%	23.7%
Obiliq	-15%	-1%	13%	72%	112%	25.8%
Rahovec	-44%	-42%	-15%	35%	39%	16.3%
Pejë	-33%	-27%	-9%	40%	72%	23.4%
Podujevë	-40%	-23%	-13%	37%	58%	21.2%
Prishtinë	-2%	-2%	20%	77%	113%	35.8%
Prizren	-35%	-34%	-8%	42%	53%	23.5%
Skenderaj	-40%	-33%	-8%	25%	52%	17.1%
Shtime	-33%	-20%	3%	37%	55%	20.7%
Shtërpçë	-1%	31%	68%	182%	139%	7.5%
Suharekë	-45%	-40%	-10%	28%	43%	20.8%
Ferizaj	-21%	-10%	10%	59%	90%	26.4%
Viti	-45%	-32%	-13%	20%	44%	20.2%
Vushtrri	-29%	-25%	-4%	41%	68%	21.9%
Zubin Potok	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	23.7%
Zveqan	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	23.0%
Malishevë	-40%	-32%	-2%	26%	37%	15.6%
Junik	-60%	-46%	-26%	23%	47%	14.7%
Mamushë	-23%	-7%	20%	47%	70%	27.9%
Hani i Elezit	-25%	-22%	0%	43%	16%	17.0%
Graçanicë	38%	59%	83%	132%	168%	25.8%
Ranillug	-38%	-54%	-31%	-31%	-22%	12.6%
Partesh	41%	5%	106%	164%	321%	8.6%
Kllokot	-6%	-18%	46%	37%	174%	12.5%
Mitrovicë Veriore	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	23.3%
Kosovë	-28.6%	-23.6%	1.0%	49.5%	69.4%	24.1%

Tab. 5: Karakteristikat Socio-Ekonomike të Popullsisë sipas Komunave

Komunat	% Arsimi i mesëm i lartë dhe i lartë 25-64	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 15-24	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 25-64	Papunësi a Moshë 15-24	Papunësia Moshë 25-64	Ekonomikisht aktive 65-84	Burimi i të ardhurave nga puna	Burimi i të ardhurave nga pensionet	Burimi i të ardhurave nga Remitancat
Deçan	56.3%	28.0%	37.4%	27.9%	23.8%	1.0%	19.2%	14.4%	4.4%
Gjakovë	56.8%	36.5%	52.3%	22.1%	14.2%	2.7%	27.1%	13.5%	4.4%
Glllogoc	58.9%	39.4%	50.2%	19.4%	17.2%	1.0%	24.0%	10.9%	3.2%
Gjilan	65.9%	39.6%	58.1%	23.0%	15.8%	2.1%	28.0%	10.9%	3.1%
Dragash	42.9%	24.6%	32.6%	47.1%	29.3%	1.6%	15.7%	12.8%	2.9%
Istog	56.3%	32.5%	46.5%	18.8%	12.6%	1.7%	29.1%	11.4%	4.2%
Kaçanik	62.2%	37.4%	47.9%	24.4%	18.6%	1.5%	21.7%	10.3%	2.8%
Klinë	47.7%	31.3%	41.6%	27.3%	20.9%	1.7%	18.7%	12.1%	6.2%
Fushë Kosovë	72.8%	44.3%	64.7%	10.6%	7.0%	2.4%	35.2%	7.4%	1.6%
Kamenicë	61.7%	34.7%	46.9%	25.8%	19.7%	1.4%	24.0%	14.5%	4.3%
Mitrovicë	66.8%	40.0%	55.5%	26.8%	19.0%	1.8%	25.1%	12.5%	1.7%
Leposaviq	56.5%	19.2%	37.8%	75.4%	41.3%	2.5%	17.4%	20.7%	0.3%
Lipjan	60.7%	39.5%	51.2%	13.4%	11.0%	1.2%	26.4%	9.2%	2.5%
Novobërdë	58.8%	36.4%	51.6%	15.2%	12.6%	1.6%	27.2%	11.1%	1.7%
Obiliq	68.5%	34.1%	54.1%	11.4%	9.2%	0.7%	27.9%	8.6%	1.4%
Rahovec	40.8%	26.6%	37.3%	26.5%	12.6%	2.3%	28.4%	9.5%	6.5%
Pejë	66.5%	32.1%	51.1%	19.3%	10.6%	3.2%	27.2%	12.9%	2.9%
Podujevë	58.4%	35.3%	47.3%	20.6%	13.8%	1.2%	24.8%	10.3%	3.6%
Prishtinë	82.9%	39.1%	69.9%	8.7%	5.7%	3.4%	38.7%	10.1%	0.9%
Prizren	49.1%	33.1%	48.7%	18.9%	11.3%	2.1%	25.9%	10.2%	5.5%
Skenderaj	52.4%	32.5%	42.1%	27.7%	21.0%	0.9%	18.1%	13.4%	3.2%
Shtime	59.7%	36.8%	44.8%	19.9%	14.7%	1.1%	24.2%	8.6%	4.1%
Shtërpçë	79.6%	32.1%	47.7%	58.5%	54.1%	1.6%	17.3%	18.0%	0.5%
Suharekë	49.6%	31.1%	44.9%	22.0%	12.1%	1.5%	25.6%	10.6%	7.8%
Ferizaj	66.9%	38.6%	53.2%	14.0%	10.4%	2.2%	27.9%	9.0%	2.5%
Viti	59.7%	34.4%	47.0%	27.4%	17.4%	1.6%	22.2%	9.8%	5.2%
Vushtrri	65.4%	36.1%	51.1%	17.4%	12.7%	1.8%	27.5%	11.3%	1.7%
Zubin Potok	68.5%	32.5%	51.6%	24.4%	7.3%	1.9%	24.4%	12.2%	4.1%
Zveqan	65.9%	32.8%	52.3%	20.0%	8.0%	6.3%	25.3%	9.4%	1.2%
Malishevë	39.1%	32.0%	39.8%	32.6%	18.7%	0.7%	18.0%	7.9%	9.1%
Junik	50.8%	22.3%	29.3%	16.2%	9.3%	0.8%	20.7%	15.5%	1.4%
Mamushë	26.9%	28.6%	48.6%	5.5%	1.2%	4.4%	28.8%	5.6%	1.7%
Hani i Elezit	54.9%	19.2%	31.5%	8.4%	4.9%	0.8%	15.9%	9.3%	3.1%
Graçanicë	83.3%	32.2%	62.6%	28.9%	15.0%	6.0%	27.1%	11.2%	0.2%
Ranillug	77.1%	17.5%	38.4%	43.1%	20.9%	0.7%	35.3%	18.7%	0.4%
Partesh	80.8%	23.1%	47.5%	86.5%	59.6%	1.1%	26.6%	16.8%	0.1%
Klllokot	64.2%	35.7%	47.9%	49.7%	46.0%	1.6%	19.4%	9.6%	0.5%
Mitrovicë Veriore	80.5%	26.2%	49.0%	9.0%	10.3%	1.6%	24.2%	19.3%	1.5%
Kosovë	62.5%	35.7%	52.5%	19.3%	12.7%	2.1%	27.4%	10.8%	3.3%

Fig. 61: Numri i popullsisë sipas komunave 2024




Fig. 62: Dendësia e popullsisë në km² sipas komunave 2024




Fig. 63: Njësitë banesore të banuara në % sipas komunave 2024




Fig.64: Sistemi i furnizimit me ujë nga një shërbim publik sipas komunave në % 2024




Fig. 65: Qasja në rrjetin publik të kanalizimit sipas komunave në % 2024




Fig. 66: Ekonomia familjare me një person sipas komunave në % 2024




Fig. 67: Shkalla e papunësisë e moshës 15 - 24 vjeç sipas komunave në %, 2024




Fig. 68: Shkalla e papunësisë e moshës 25 - 64 vjeç sipas komunave në %, 2024




